

Përparimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave në Shqipëri

Parashtrim i pozicionit të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri¹

Vitet e fundit Shqipëria ka bërë përparime të rëndësishme në fushën e barazisë gjinore, veçanërisht përmes hartimit të disa akteve ligjore gjithëpërfshirëse për promovimin, vënien në jetë dhe monitorimin e parimit të mosdiskriminimit në bazë të seksit dhe identitetit gjinor. Pritet që Shqipëria të zbatojë reforma të tjera në sektorë të ndryshëm, në përputhje me standardet e barazisë gjinore të vendosura nga Bashkimi Evropian. Ndonëse institucionet e vendit kanë bërë hapa të rëndësishëm përpara për t'i vënë gratë dhe vajzat në krye të përparësive kombëtare, është e nevojshme që Shqipëria të forcojë zbatimin e ligjeve dhe të politikave, llogaridhënien dhe mekanizmat e monitorimit për të siguruar arritjen e të gjithë objektivave dhe treguesve gjinorë në kuadër të Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm, si dhe për të siguruar që ndërhyrjet lidhur me pandeminë shëndetësore të trajtojnë në mënyrë specifike ndikimin që ka COVID-19 tek gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë.

Ky dokument pasqyron kontributin e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri për evidentimin e fushave kryesore të politikave dhe të strategjive për përshtetimin e arritjes së barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave në vend. Gjithashtu, ai synon të shërbejë si udhërrëfyes për partitë politike për promovimin e një agjende me përgjigjshmëri gjinore përpara fillimit të mandatit të ardhshëm legjislativ të Kuvendit të porsazgjedhur të Shqipërisë.¹

1) Vendosja e grave dhe vajzave në qendër të zhvillimit të qëndrueshëm të Shqipërisë dhe të integritit në BE

Strategjia e re Kombëtare për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Integrit, si dhe Strategjia e re për Barazinë Gjinore dhe strategji të tjera sektoriale që janë aktualisht në proces përditësimi, ofrojnë një mundësi të veçantë për identifikimin e masave kryesore që duhen ndërmarrë për promovimin e një barazie gjinore të plotë. Vendosja e grave dhe vajzave në qendër të përpjekjeve për zhvillim të qëndrueshëm dhe integrit në BE duhet të mbështetet në katër boshte strategjike, si shtimi i investimeve për eliminimin e mangësive në zbatimin e angazhimeve ekzistuese, statistika gjinore të plota dhe të sakta, mekanizma të fuqizuar për bashkërendimin e veprimeve dhe monitorimin e rezultateve, përdorimi i aftësive drejtuese të grave kapacitete udhëheqëse të pakufizuara të grave, si dhe përfaqësimi dhe pjesëmarrja e barabartë e tyre në vendimmarrje në të gjitha nivelet.

I) **Shtimi i fondeve për ndërhyrjet në fushën e barazisë gjinore** është me rëndësi thelbësore për arritjen e rezultateve të zhvillimit të qëndrueshëm. Ndonëse Shqipëria ka bërë mjaft përparim në zbatimin e planifikimit dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, duhet bërë më shumë për të siguruar që shpërndarja dhe përdorimi i burimeve publike t'u përgjigjet drejtpërsëdrejti shqetësimeve të vazhdueshme lidhur me pabarazitë gjinore dhe të drejtat e fëmijëve. Gjithashtu, strategjitë dhe programet kombëtare duhet të jenë të shoqëruara me llogaritjen e kostos së tyre financiare dhe që ekzistojnë kapacitete dhe mekanizma të mjaftueshme për të monitoruar përdorimin faktik të burimeve.

II) **Mangësive ekzistuese në statistikat gjinore**, duhet t'u kushtohet vëmendje për të mundësuar matjet e duhura të rezultateve të arritura në fushën e barazisë gjinore dhe për të vlerësuar me objektivitet ndikimin e politikave dhe të investimeve. Mungesa e të dhënave të ndara në bazë të seksit, moshës, vendbanimit qytet-fshat, situatës social-ekonomike dhe ligjore në të gjithë sektorët, përbën një sfidë të cilës duhet t'i jepet zgjidhje përmes gjenerimit dhe vënies në dispozicion të të dhënave të besueshme.

¹ Ky dokument mbështetet në të dhënat statistikore ekzistuese në vend dhe u hartua mbi bazën e procesit të *Universal Peer Review* (Shqyrtimi Periodik Universal) që Shqipëria ndërmori në Këshillin e të Drejtave të Njeriut të OKB-së në vitin 2019, lidhur me vërejtjet përmblyëse të Komitetit mbi Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave dhe organeve të tjera të traktateve të OKB-së, si edhe lidhur me *Gender Action Plan III* (Plani i Veprimit Gjinor III) të Bashkimit Evropian.

III) **Udhëheqja efektive dhe bashkërendimi efikas i aktorëve** në nivelet qendrore dhe vendore janë me rëndësi thelbësore për të siguruar trajtimin e vazhdueshëm të pabarazive gjinore në të gjitha fushat e veprimit të qeverisë. Ligji 9970/2008 për Barazinë Gjinore krijoi një mekanizëm të posaçëm që përfshin Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore, një Njësi të Barazisë Gjinore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe një rrjet nëpunësish që merren me çështje të barazisë gjinore në ministri dhe institucione. Megjithatë, në organizimin e përgjithshëm të tyre vërehet një numër mangësish në aspektet e fuqizimit politik dhe qartësisë së roleve dhe përgjegjësi, fondeve të pamjaftueshme, kapaciteteve të dobëta dhe mungesës së bashkëpunimit sistematik ndër-institucional, si ndërmjet aktorëve në nivel qendror, ashtu edhe me njësitë e qeverisjes vendore. Në këto rrethana, sigurimi i bashkërendimit, monitorimit dhe vlerësimit efektiv të integritetit gjinor në politika dhe programe bëhet mjaft i vështirë.

IV) **Me rëndësi kyçe është zgjerimi i rolit udhëheqës të grave dhe vajzave.** Është e pamohueshme se janë bërë përpjekje të konsiderueshme në fushat e pjesëmarrjes dhe të përfaqësimit të grave në role drejtuese. Në sajë të kuotave gjinore, numri i grave deputete në Kuvendin e Shqipërisë dhe në këshillat bashkiakë u rrit përkatësisht në 26,2 për qind dhe 35,9 për qind, dhe pritet përpërim i mëtejshëm pas zgjedhjeve të fundit parlamentare. Me 45,5 për qind të posteve ministrore që përfaqësohen nga gra, Shqipëria renditet ndër dhjetë vendet e para në botë; 48,1 për qind e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë janë gra, krahasuar me mesataren prej 20,3 për qind në bankat qendrore të vendeve të Bashkimit Evropian. Për ruajtjen e këtyre arritjeve në vijimësi është e nevojshme t'i jepet më shumë hapësirë një udhëheqjeje të mirëfilltë nga gratë në politikë dhe ekonomi, përmes promovimit të rolit të tyre si agentë ndryshimi dhe si kontribuese - njësoj si burrat dhe djemtë - në marrjen e vendimeve që do të ndikojnë rrugën e zhvillimit të vendit gjatë viteve të ardhshme. Sikurse dëshmohet edhe nga përvojat e vendeve të tjera anembanë globit, aty ku ka më shumë gra në poste drejtuese dhe ku zëri i grave dhe i vajzave dëgjohet, vërehen forma më të civilizuar dhe më bashkëpunuese të dialogut politik, me një respektim më të madh të diversitetit dhe kundërshtarëve politikë, si dhe ka përpjekje më sistematike për të gjetur gjuhën dhe qëndrimet e përbashkëta për çështje që ndikojnë në jetën e njerëzve përtej ndasive partiake. Zgjedhjet e fundit parlamentare ofruan një mundësi për rikrijimin e një mjedisi politik përfshirës i cili respekton të drejtat e grave dhe të fëmijëve dhe jetën familjare të kandidatëve burra dhe gra dhe përkrahësve të tyre, duke u kushtuar vëmendje nevojave dhe interesave të ndryshme të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, duke u mundësuar atyre që nuk kanë zë që ta thonë fjalën e tyre, dhe duke promovuar pjesëmarrjen e elektoratit votues dhe jo votues. Megjithatë, një analizë paraprake e raportimeve në media në lidhje me zgjedhjet, qoftë para apo pas zhvillimit të tyre, sugjeron se gratë kandidatë dhe votuese vazhduan të përballeshin me disa sfida lidhur me pjesëmarrjen e tyre të plotë në fushatë, ku u vërejtën raste ngacmimesh dhe etiketimesh negative bazuar në gjininë ose pamjen e jashtme.

2) Eliminimi i të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore, praktikave të dëmshme dhe dhunës ndaj fëmijëve

Dhuna ndaj grave dhe vajzave mbetet një nga çështjet më urgjente në shoqërinë shqiptare, që kërkon vëmendje dhe ndërhyrje prioritare. Normat patriarkale të rrënjësura thellë përjetësojnë dhe përligjin dhunën, abuzimin dhe diskriminimin, duke krijuar kështu pengesa të mëdha për arritjen e barazisë së vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, vajzave dhe djemve. Të dhënat ekzistuese tregojnë se të paktën një ndër dy gra ka përjetuar ndonjë lloj dhune, në formën e dhunës në familje ose dhunës seksuale, ngacmimit, dhunës nga një person që nuk është partneri i saj, martesës në moshë të mitur ose martesës së detyruar, dhe përndjekjes. 26 për qind e grave të moshës 18-74 vjeç besojnë se gruas duhet t'i vijë turp të flasë me ndokënd nëse është përdhunuar, ndërsa 21 për qind mendojnë se, në qoftë se një grua është përdhunuar, ajo ndoshta ka bërë diçka që e ka shkaktuar atë situatë. 60 për qind e veprave penale seksuale kryhen ndaj të miturve dhe afërsisht një ndër dy fëmijë është objekt i sulmeve fizike ose psikologjike. Të dhënat tregojnë gjithashtu për ekzistencën e një lidhjeje të ngushtë ndërmjet abuzimit seksual të fëmijëve dhe dhunës me bazë gjinore në moshë të rritur. Mekanizmat e koordinuar të referimit (MKR) dhe njësitë për mbrojtjen e fëmijëve të ngritura në bashki nuk janë plotësisht funksionale; shërbimet mbështetëse nuk kanë burime njerëzore dhe fonde të mjaftueshme dhe nuk janë të përshtatura për të trajtuar të gjitha format e dhunës me bazë gjinore dhe për t'ju përgjigjur nevojave të të gjitha grupeve të personave në nevojë. Përkufizimi ligjor i përdhunimit në Kodin Penal vazhdon të jetë një përkufizim që bazohet tek përdorimi i forcës dhe barra e provës bie mbi viktimën. Legjislacioni ka mangësi në fushat e sigurisë në përdorimin e internetit dhe mungojnë dispozitat ligjore për mbrojtjen e viktimave të veprave penale të tjera përveç dhunës në familje (si për shembull, përndjekja, ngacmimi apo sulmi seksual) dhe, për rrjedhojë, MKR-të nuk janë të detyruara me ligj që t'i trajtojnë raste të tilla. 68,8 për qind e grave (krahasuar me 31,2 për qind të burrave) janë të mendimit se sistemi i drejtësisë nuk i mbron dhe se ai nuk u përgjigjet siç duhet nevojave të fëmijëve. Rezistenca kulturore ndaj ndryshimit në organet përgjegjëse dhe ekzistenca në vijimësi e diskriminimit

dhe varfërisë, kufizojnë aksesin në drejtësi për viktimat e dhunës me bazë gjinore që u përkasin grupeve të ndryshme, përfshirë komunitetin rom dhe egjiptian, emigrantët dhe refugjatët, komunitetin LGBTQI, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, si dhe fëmijët viktimë të krimit ose në konflikt me ligjin. Me shpërthimin e pandemisë COVID-19, dhuna me bazë gjinore ka çuar gjithnjë e më shumë në krijimin e një 'pandemie të fshehur' të cilën politikë-bërësit duhet ta trajtojnë në tërësinë dhe kompleksitetin e saj, ndër të tjera duke i dhënë përparësi tri qasjeve strategjike:

I) **Sigurimi i udhëheqjes dhe llogaridhënies:** Aktorët shtetërorë, ndër të cilët parlamenti, qeveria, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organet gjyqësore duhet t'u japin përparësi çështjeve të dhunës ndaj fëmijëve dhe dhunës me bazë gjinore; autoritetet që janë përgjegjëse për promovimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të fëmijëve duhet të fuqizohen dhe të pajisen me burimet dhe kapacitetet e duhura për të udhëhequr veprimet reaguese dhe bashkërendimin e tyre. Udhëheqja politike është me rëndësi kyçe, ndër të tjera edhe përmes Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore dhe Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës. Institucionet kombëtare duhet të nxisin ndërmarrjen e veprimeve, të mbikëqyrin përparimin dhe të përshtatin veprimet, duke nxjerrë mësim nga sukseset dhe dështimet. Këtu përfshihet edhe nevoja për një bashkërendim më të mirë të punës me aktorët vendorë: kryetarët e bashkive dhe këshillat bashkiakë, policinë dhe gjykatat, mekanizmat e koordinuar të referimit, personelin e shkollave, OJQ-të vendore dhe punonjësit socialë. Të gjithë këta aktorë janë në vijën e parë të frontit dhe duhet të jenë të aftë të përmbushin përgjegjësitë e tyre.

II) **Më shumë investime:** nevojiten më shumë burime për të siguruar zbatimin e plotë të ligjeve ekzistuese. Ndonëse Shqipëria ka bërë përparim të rëndësishëm në harmonizimin e kornizës së saj legjislative me standardet normative ndërkombëtare, është e nevojshme të bëhen ndryshime të tjera për të luftuar në mënyrë efektive dhunën seksuale, ngacmimin seksual dhe përndjekjen, qoftë *online* ose jo. Paketa e plotë e shërbimeve duhet të jetë lehtësisht e aksesueshme nga të gjithë personat në nevojë. Këtu përfshihet edhe forcimi i një qasjeje që vë në qendër viktimën dhe siguron më shumë mbrojtje për personat e mbijetuar, përmes ofrimit të ndihmës juridike dhe zbatimit në kohë të urdhrave të mbrojtjes. Duhet të ofrohen mundësi për përdorimin e shërbimeve të këshillimit shëndetësor dhe psikologjik, mbrojtjes sociale, strehimit, si edhe mundësi për sigurimin e të ardhurave. Gratë dhe vajzat e të gjitha kombësive, moshave, dhe prejardhjeve, përfshirë edhe gratë azilkerkuese dhe refugjate, duhet të kenë akses në streha emergjence funksionale. Linjat telefonike kombëtare në ndihmë të qytetarëve/eve dhe rrugët e referimit duhet të bëhen të qëndrueshme, të kenë objektiva të qarta, fonde dhe burime njerëzore të mjaftueshme. Duhet të mbështeten përpjekjet e shoqërisë civile, ndër të tjera edhe ato për trajtimin e dimensioneve të ndërthurura të dhunës me bazë gjinore (si për shembull, prejardhja etnike, mosha, aftësitë e kufizuara, vendbanimi, etj.). Zbatimi i dobët sjell si pasojë një shkallë të ulët besimi tek sistemi, duke bërë që viktimat të vazhdojnë të mbeten në hije..

III) **Trajtimi me përparësi i edukimit, dialogut dhe ndërgjegjësimin publik.** Burrat dhe djemtë shqiptarë vazhdojnë t'u përmbahen stereotipeve të roleve gjinore, që shpesh lidhen me një rreth të mbyllur agresiviteti. Paralelisht me punën për t'i ndihmuar djemtë që të kuptojnë se 'burrat e vërtetë' janë feministë, është me rëndësi thelbësore që vajzat të ndihmohen që të bëhen plotësisht të vetëdijshme për vlerën e tyre, me qëllim që të luftohet kundër stereotipeve të dëmshme që i pengojnë ato të realizojnë potencialin e tyre të plotë. Nevojitet një angazhim i mbarë shoqërisë, me shkolla të pajisura dhe të përgatitura për të qenë në pararojë të promovimit të të drejtave të njeriut dhe të luftës kundër qëndrimeve patriarkale, përmes mobilizimit të nxënësve, prindërve, kujdestarëve dhe anëtarëve të komunitetit në diskutime mbi tema si mbrojtja e fëmijëve, barazia dhe mosdiskriminimi, diversiteti kulturor dhe racor, edukimi në lidhje me seksualitetin, maskulinitetin, fuqizimi i vajzave dhe vetëmbrojtja, si dhe përdorimi i sigurt i internetit. Një rol të jashtëzakonshëm për çrrënjosjen e kulturës së stereotipizimit gjinor, dhunës dhe abuzimit, luan edhe informimi i publikut. Mediat duhet të jenë pjesë e zgjidhjes, përmes raportimit mbi zbatimin e ligjeve dhe politikave, mbështetjes së të mbijetuarave në vend që të përligjin autorët e dhunës, si dhe duke u ofruar mundësi të rinjve dhe të rejave që nuk pajtohen me këtë *status-quo* që të shprehin mendimin e tyre. Përveç kësaj, duhet t'i jepet përparësi edhe mbrojtjes së privatësisë të personave të mbijetuar: publikimi i informacioneve me të dhënat personale të viktimave (veçanërisht të të miturve) nuk duhet të tolerohet.

3) Forcimi i drejtësisë ekonomike dhe fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave

Në Shqipëri vazhdojnë të ekzistojnë pabarazi të mëdha gjinore në mundësitë ekonomike, si pjesëmarrja e ulët në fuqinë punëtore, nivele të larta informaliteti dhe akses i ulët në burimet prodhuese. Ndonëse shkalla e

përgjithshme e aktivitetit të punës në popullatën e moshës 15-64 vjeç është rritur në mënyrë të qëndrueshme gjatë viteve, pjesëmarrja e grave në forcat e punës vazhdon të jetë më e ulët (61,6 për qind) se sa e burrave (77,6 për qind). Zgjedhjet që bëjnë gratë dhe vajzat kufizohen nga ekzistenca e stereotipeve në punësim, sepse ato punojnë kryesisht në shërbimin shëndetësor dhe social, në arsim, fabrika dhe bujqësi – që të gjithë këta sektorë të karakterizuar nga paga të ulëta. Bujqësia mbetet sektori parësor i punësimit të grave (41,6 për qind gra, krahasuar me 32,3 për qind burra). Përveç kësaj, shkak i mosaktivizimit të grave në tregun e punës është edhe mosplotësimi i nevojave të përkujdesit për fëmijët. Gratë bëjnë 96 për qind të punëve të shtëpisë dhe nuk janë të punësuar kryesisht për shkak të angazhimit të tyre në shërbimet e përkujdesit për persona të tjerë në familje – këto angazhime i kanë 18 për qind e grave krahasuar me 1 për qind të burrave. Në mënyrë të ngjashme, vajzat kryejnë pothuaj katër herë më shumë punë të papaguar përkujdesi krahasimisht me djemtë. Hendeku gjinor në paga në sektorin formal të punës është 10,1 për qind në favor të burrave. Ndonëse hendeku gjinor në paga është më i vogël se sa mesatarja në vendet e Bashkimit Evropian, në Shqipëri kjo vjen gjithashtu si rezultat i pjesëmarrjes më të ulët të grave në tregun e punës, ndërkohë që hendeku gjinor në paga është më i madh në sektorët ku janë të përqendruara gratë. Po kështu, përqendrimi i grave dhe vajzave në ekonominë informale dhe në një numër të paktë sektorësh frenon rritjen e përgjithshme ekonomike të vendit, ndërkohë që ekziston një konsensus gjithnjë e më i gjerë se Shqipëria duhet të shtojë produktivitetin dhe të diversifikojë mundësitë e punësimit dhe të arsimimit (për shembull, në fushat e shkencës, teknologjisë së informacionit dhe sipërmarrjes).

Pjesëmarrja e grave në biznes është rritur gjatë dhjetëvjeçarit të fundit dhe 25,4 për qind e bizneseve në vend drejtohen nga gra ose janë në pronësi të grave. Megjithatë, pjesa më e madhe e sipërmarrjeve të grave janë biznese shumë të vogla ose të vogla me kapital të pamjaftueshëm, kryesisht në sektorët informalë dhe me normë fitimi të ulët (për shembull në manifakturë dhe bujqësi). Pjesëmarrja aktive e grave në zhvillimin e sektorit privat mbetet e ulët, sidomos për gratë në zonat rurale, dhe ndikimi i sjelljeve dhe normave diskriminuese gjinore është i pranishëm në të gjitha nivelet. Pabarazitë gjinore në aksesin në kredi nuk janë zvogëluar me kalimin e viteve. Përveç kësaj, ndonëse zyrtarisht gratë gëzojnë të drejta të barabarta të trashëgimisë dhe pronësisë mbi tokën dhe pronën, mbi 80 për qind e titujve të pronësisë mbi tokën vazhdojnë të jenë në emër të “kryefamiljarit” (kryesisht bashkëshorti, vjehri, vëllai, babai, gjyshi), çka kufizon të drejtat e grave mbi burime prodhuese, si e drejta për regjistrimin e biznesit, e drejta për përfitimin e kredive dhe të shërbimeve këshillimore bujqësore, si dhe mundësitë e tyre për t’u larguar nga një marrëdhënie e dhunshme. Për të forcuar drejtësinë ekonomike dhe fuqizimin e grave dhe të vajzave, duhet t’u jepet përparësi veprimeve të mëposhtme.

I) **Promovimi i punës së denjë, pagave të barabarta dhe të drejtave të punonjësve, si dhe i kalimit të grave nga ekonomia informale në atë formale**, përmes reduktimit të segregimit në tregun e punës, rritjes së rolit drejtues të grave dhe të fuqisë së tyre negociuese në familje lidhur me vendimet ekonomike. Nevojiten investime më të mëdha në shërbime cilësore të përkujdesit, reforma në legjislacion dhe politika, krijimi i punëve të denja të përkujdesit për njohjen, reduktimin, rishpërndarjen dhe shpërblimin e punës së papaguar të përkujdesit, si dhe për garantimin e të drejtave dhe përfaqësimin e personave që punojnë në fushën e përkujdesit.

II) **Nxitja dhe fuqizimi i sipërmarrjeve të grave dhe i bizneseve të drejtuara nga gratë**, përfshirë sipërmarrjet sociale dhe aksesin në financime përmes ofrimit të skemave investuese inovative, për adresimin e paaftësisë së tregut për të promovuar krijimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të drejtuara nga gratë. Ndër veprimet e tjera të synuara duhet të përfshihen edhe shërbimet për zhvillimin e bizneseve dhe mbështetja e punësimit, përfshirë edhe për gratë dhe vajzat që kanë pasur më parë probleme me ligjin ose me drogën, si dhe punësimi në ekonominë e gjelbër. Është e nevojshme të krijohet një mjedis që mundëson aktivitetet ekonomike të grave dhe aksesin e tyre në burimet prodhuese, përfshirë aksesin e grave në përdorimin e tokës, në të ardhurat nga emigracioni, në teknologji dhe financë.

III) **Kundërvënja ndaj normave gjinore ekzistuese brenda familjes dhe në tregun e punës**, përmes njohjes së roleve dhe përgjegjësisë të burrave dhe djemve, duke nxitur reforma ligjore si përfshirja në ligj e dispozitave për lejen e paguar të atësisë.

4) Investime për shëndetin dhe arsimimin e grave

Shqipëria shpenzon afërsisht 3 për qind të PBB-së për shëndetësinë dhe arsimin, krahasuar me 9,9 për qind të PBB-së që shpenzohet mesatarisht në vendet e Bashkimit Evropian. Nuk ka asnjë studim gjithëpërfshirës lidhur me ofrimin e shërbimit shëndetësor për të gjithë dhe lidhur me aksesin e barabartë në shërbimin shëndetësor.

Pagesat janë të larta dhe përbëjnë një pengesë të madhe për gratë që jetojnë në zonat rurale dhe të thella, si dhe për gratë rome dhe egjiptiane të cilat kanë akses të kufizuar në shërbimin shëndetësor parësor dhe në shërbimet e shëndetit seksual e atij riprodhues. Ekziston nevojë e ngutshme për të hartuar dhe përshtatur shërbimet e duhura për adoleshentët, aksesit i të cilëve në shërbimet e shëndetit riprodhues vazhdon të jetë i pamjaftueshëm, veçanërisht nëse merret parasysh ndikimi i shtatzënive të padëshiruara tek vajzat (numri i lindjeve nga vajzat adoleshente është shumë më i lartë krahasimisht me mesataren e Bashkimit Evropian: 14,2 për 1000 lindje krahasuar me 9,2 në BE). Personat LGBTQI përballen me shumë vështirësi në përdorimin e shërbimeve shëndetësore për shkak të orientimit seksual dhe identitetit të tyre gjinor. Studimet e kohëve të fundit sugjerojnë se ende praktikohen abortet përzgjedhëse në bazë të seksit të foshnjës. Numri i saktë i foshnjave interseks të lindura mbetet ende i paqartë dhe informacioni për ndërhyrjet kirurgjikale që kryhen në këto foshnja nuk është i disponueshëm.

Nevojiten politika dhe investime të fokusuara për të siguruar që gratë të gëzojnë të drejtat e tyre shëndetësore pa asnjë diskriminim. Këtu duhet të përfshihen: I) Përmirësimi i aksesit në shërbimet shëndetësore dhe shërbimet e parandalimit në shëndetin publik, sidomos për sa i përket aksesit në këto shërbime të grave që u përkasin pakicave kombëtare dhe të vajzave të reja, si dhe për parandalimin e HIV-it dhe zhvillimin e edukimit seksual; II) Marrja e masave të efektshme për eliminimin e diskriminimit të personave LGBTQI, sigurimin e aksesit pa diskriminim të personave LGBTQI në shërbime shëndetësore dhe përfshirja e edukimit lidhur me personat LGBTQI në programet shkollore.

Rezultatet arsimore të deritanishme kontribuojnë konsiderueshëm në pabarazitë gjinore në tregun e punës dhe në hendekun gjinor në paga. Pavarësisht nga rezultatet më të larta shkollore të vajzave në arsimin e mesëm, në arsimin e lartë janë të pranishme dallimet dhe ndarjet gjinore në degët e studimit të ndjekura. Në arsimin profesional, pjesa më e madhe (afërsisht 82 për qind) janë djem, kryesisht për shkak të ekzistencës së stereotipeve lidhur me “profesionet e burrave”, mjedisit social në shkollat profesionale, llojeve të programeve shkollore të ofruara, si dhe perspektivave për punësim të vajzave pas mbarimit të shkollës. Nga ana tjetër, në arsimin universitar, 60 për qind e studentëve janë vajza, krahasuar me 40 për qind djem. Vajzat ndjekin studimet më shumë në fushat e mësimdhënies, shëndetësisë e mirëqenies, si dhe në shkencat shoqërore, ndërsa djemtë mbizotërojnë në fushat e shërbimeve, inxhinierisë, manufakturës dhe ndërtimit, bujqësisë, pylltarisë, peshkimit dhe veterinarisë. Ndonëse numri i vajzave që marrin diplomë universitare është më i madh krahasuar me atë të djemve, numri i vajzave që bëhen pjesë e forcave të punës është më i ulët dhe nuk i përgjigjet nivelit të kualifikimit të tyre arsimor. Shkollat dhe universitetet mund të luajnë gjithashtu një rol shumë më aktiv për zhdukjen e mendësisë patriarkale dhe stereotipeve gjinore të rrënjosura thellë të cilat vazhdojnë t'i lënë gratë mbrapa, si dhe të rishikojnë kriteret e regjistrimit për të lejuar përfshirjen e më shumë djemve dhe vajzave refugjate në sistemin arsimor.

Për kapërcimin e këtyre sfidave duhet të ndërmerren veprime të bashkërenduara në këto fusha: I) T'i jepet përparësi një arsimit gjithëpërfshirës dhe të përballeshëm financiarisht, përmes krijimit të strukturave arsimore më të forta dhe më të përgjigjshme gjinore për promovimin e barazisë gjinore, mosdiskriminimit dhe gjithëpërfshirjes. Po ashtu, duhet të mundësohen dhe arrihen rezultate më të barabarta arsimore për vajzat dhe djemtë përmes krijimit të mjediseve të sigurta dhe të shëndetshme të dijës, përfshirë edhe në fushat e punësimit, formimit dhe zhvillimit profesional të mësuesve, hartimit të programeve dhe materialeve mësimore me përfshirjen edhe të prindërve dhe komuniteteve. Këtu do të përfshihej edhe garantimi i arsimit të detyrueshëm dhe me kohë të plotë për të gjitha vajzat dhe të gjithë djemtë nga grupet e pakicave, për personat me aftësi të kufizuara dhe ata që jetojnë në zona rurale. II) Të investohet më shumë në arsimimin e vajzave për të arritur akses të barabartë në të gjitha format e arsimit dhe të formimit profesional, me më shumë fokus në fushat e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës, njohuritë dhe aftësitë digjitale, si dhe në arsimin dhe formimin teknik dhe profesional. III) Shkollat e të gjitha niveleve duhet të shërbejnë si pika hyrjeje strategjike për të luftuar stereotipet gjinore, normat sociale dhe qëndrimet diskriminuese që ende i lënë gratë dhe vajzat mbrapa, duke u fokusuar mbi dhunën me bazë gjinore dhe mirëqenien dhe sigurinë fizike/mendore si të djemve, ashtu edhe të vajzave.

ⁱ Dokumenti origjinal është përgatitur në anglisht